

Shërbimet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike:

- Prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm.
- Mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura.
- Mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmytjet në zonat e banuara.
- Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.
- Ndriçimi i mjediseve publike.
- Transporti publik vendor.
- Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit.
- Shërbimi i dekorit publik.
- Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.
- Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.
- Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.
- Administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.
- Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimi i aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

- Planifikimi, administrimi, zhvillimi dhe kontrolli i territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.